



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:160468

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05582949

C.nr.682/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.G nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokatja S.B nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpërblimit jubilar, vlera e objektit të kontestit 1,425.07 euro, jashtë seancës, më datën 17.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT e bazuar kërkesëpadia e paditësit V.G.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit V.G, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 353 ditë pune të ja paguajë shumën prej 706.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 25.07.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit V.G, në emër të kompensimit për udhëtim për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 353 ditë pune të ja paguajë shumën prej 494.20 euro duke e llogaritur nga 70% e shumës prej 1.40 euro për çdo biletë (70% i 2 euro = 1.40 euro), me kamatë ligjore 8% nga data 25.07.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësit V.G me të cilën ka kërkuar që e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit në emër të shpërblimit jubilar për 10 vjetorin e përvojës së punës t'ia kompensojë shumën prej 224.87 euro.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit V.G, t'i paguajë shumën prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi V.G, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 25.07.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë dhe kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në shumën prej 1,425.07 euro.

I njëjti sipas padisë ka theksuar se ka punuar dhe vazhdon të punojë si mësimdhënë në SHFMU “Gëzim Hamza - Piktori” në Rahovec, e që për periudhën e kërkuar paditësit i ka takuar drejta e kompensimit të ushqimit në punë dhe udhëtimit dhe shpërblym jubilar, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 18.04.2017, por që deri më tani nuk është kompensuar. Periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 21.01.2021 e deri më 21.11.2022 dhe atë për 353 ditë të prezencës në punë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 09.02.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse rezulton e pavlefshme. Më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Padia e paditësit nuk është e bazuar në asnjë bazë të vlefshme juridike, dhe nga provat e paraqitura dhe pretendimet e parashtruara, paditësi nuk ka arritur të argumentoj themelësinë e kërkesëpadisë. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit. Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh. Gjithashtu, MASHTI, e ka shkëputur Kontratën Kolektive të datës 21.01.2021.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 776/01 i datës 13.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Gëzim Hamza - Piktori” në Rahovec; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 41/1 i datës 04.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sadedin Hajda” në Rahovec; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 39/1 i datës 03.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sadedin Hajda” në Rahovec; listën e pagave për muajin shkurt të vitit 2022 për paditësin; vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit, i datës shtator 2023, i lëshuar nga K; certifikata e vendbanimit me numër serik B10450291 për paditësin e lëshuar më datën 12.04.2023 nga Zyra

e Gjendjes Civile në Rahovec; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 776/01 i datës 13.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Gëzim Hamza - Piktori” në Rahovec.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, 398 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësi për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësit pagesa e ushqimit, udhëtimit për çdo ditë të prezencës në punë dhe e drejta e shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës.

Me administrimin e vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 776/01 i datës 13.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Gëzim Hamza - Piktori” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësi V.G në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 297 ditët e punës.

Me administrimin e vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 41/1 i datës 04.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sadedin Hajda” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësi V.G në periudhën kohore prej datës 18.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 56 ditët e punës.

Me administrimin e vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 39/1 i datës 03.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sadedin Hajda” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësi V.G në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 297 ditët e punës.

Me administrimin e listës së pagave të muajit gusht 2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi kishte pagën bazë prej 421.00 euro.

Me administrimin e vërtetimit të çmimit të biletës së udhëtimit, muajit prill 2023, i lëshuar nga K, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Drenoc - Rahovec është 2 euro në dy drejtime.

Me administrimin e certifikatës së vendbanimit prej datës 31.08.2023, vërtetohet se paditësi V.G jeton në fshatin Drenoc, Komuna e Rahovecit.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë të paditësit për faktin se paditësi në periudhën kohore nga data 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e tij të punës ka prezantuar në 353 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësi ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadsë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të

Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*. Në rast se shumëzohen 353 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 706.00 euro. Ndërkaq sipas nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Në rast se shumëzohen 353 ditët e prezencës në punë me 70% të shumës prej 2 euro për çdo biletë (70% i euro = 1.40 euro) do të kemi shumën e përgjithshme prej 494.20 euro.

Gjykata ka vendosur ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar kompensimin e shpërblimit jubilar në shumën prej 224.87 euro për faktin se në kohën kur paditësi ka arritur vitin e dhjetë jubilar nuk kishte kontratë të vlefshme kolektive. Edhe pse më datën 22.01.2021 është lidhur Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, njëra palë kontraktuese më datën 22.11.2022 është tërhequr nga zbatimi i kësaj Kontrate Kolektive. Në këtë Kontratë Kolektive kanë qenë të parapara edhe hapat e kontestimit të shkëputjes së kësaj Kontrate, mirëpo nga pala tjetër nënshkruese nuk janë paraqitur prova me të cilën do ta dëshmonin se është kontestuar vlefshmëria e Kontratës Kolektive. Këtë qëndrim e mban edhe Gjykata Supreme e Kosovës, e cila në mendimin e saj juridik me numër 214/2023 të datës 05.10.2023, ka theksuar se *“Në rrethana të tilla, kjo gjykatë vlerëson se rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga kjo kontratë duhet trajtuar sipas kësaj kontrate dhe atë deri me datën 21.11.2022, kur është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese, marrë për bazë arsyet e paraqitura më lartë”*. Fakt vendimtar me të cilin gjykata ka vendosur që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit është pikërisht vërtetimi me numër 776/01 i datës 13.04.2023, me të cilin vërtetohet se në këtë periudhë paditësi kishte 9 vite përvojë pune, ndërsa i njëjti kur e ka arritur vitin e 10-të të përvojës së punës kjo kontratë nuk ishte në fuqi, me çka nuk e përfshin periudhën kohore kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, e cila është shkëputur më datën 22.11.2022.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e më tutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se*

faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpapia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.682/2023, më datën 17.04.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.